

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS

SEKSIONI: 900 KOMUNITETI
TITULLI: Politika e Drejtorisë për
Përfshirjen e Prindit dhe Familjes

ADOPTUAR: 24 Gusht 2011

RISHIKUAR: 15 Dhjetor 2016

918. POLITIKA E DREJTORISË PËR PËRFSHIRJEN E PRINDIT & FAMILJES

Oëllimi

Drejtorja Arsimore e Filadelfias (Drejtorja) njeh faktin, që edukimi i një fëmije është një përgjegjësi që ndahet nga prindërit, familjet, shkollat, dhe komuniteti, gjatë gjithë periudhës që ai vazhdon shkollën. Krijimi i një bashkëpunimi pozitiv midis familjes, shkollës dhe komunitetit, është esencial në mbajtjen e një përgjegjësie të përbashkët, të nevojshëm për përmirësimin e shkollave, dhe që përforcon rëndësinë e arritjeve mësimore.

Politika e Përfshirjes të Prindit dhe Familjes, është adoptuar në mënyrën që:

1. Mbështet dhe siguron një bashkëpunim efektiv të fuqishëm midis prindërve, familjeve, shkollave dhe komunitetit, të cilat përmirësojnë cilësinë mësimore dhe performancën e nxënësve;
2. Ofron koordinimin, asistencën teknike dhe asistencën tjetër të nevojshme për shkollat në planifikimin dhe implementimin e aktiviteteve, që përfshijnë familjet në përmirësimin e arritjeve mësimore të nxënësve, performancën e shkollës; dhe
3. Është në pajtim me kërkesat e “Title I, Part A” në lidhje me krijimin e një politike të përfshirjes të prindit dhe familjes, sipas Seksionit 1116 të aktit “Çdo nxënës të jetë i Suksesshëm (ESSA).

Kjo politikë do të shërbejë si një dokument i shkruar, i përkushtimit të Drejtorisë, që garanton se prindërit dhe familjet janë të mirëpritur, të përfshirë dhe të vlefshëm si pjesë kryesore në edukimin e fëmijëve të tyre.

Përcaktimet

Drejtori– i referohet Drejtorisë Arsimore të Filadelfias.

Kujdestari– ky term mund të përdoret në disa rrethana dhe përfshin prindin, familjen, një kujdestar legal, ose një person tjetër që qëndron në rolin e prindit (i tillë si gjyshi, njerku me të cilin jeton, një person që është ligjërish përgjegjës për fëmijën, ose një person i caktuar ligjërish për edukimin e fëmijës

Përfshirja e Prindit dhe Familjes- presupozon pjesëmarrjen e prindërve dhe familjeve në komunikim të rregullt dhe kuptimplotë, të dyanshëm, për arritjet mësimore të nxënësit dhe aktivitetet e tjera shkollore, përfshirë sigurinë —

- a) që kujdestarët të luajnë një rol integral në ndihmën për mësimin e fëmijës së tyre;
- b) që kujdestarët janë të nxitur të përfshihen aktivisht në edukimin e fëmijës së tyre në shkollë;
- c) që kujdestarët janë partnerë të plotë në edukimin e fëmijës dhe përfshihen sipas rastit në vendimmarrjet dhe këshillat konsultativë, për të asistuar edukimin e fëmijës së tyre; dhe
- d) kryerjen e aktiviteteve të tjera, si ato që përshkruhen në seksionin 1116 të ESSA.

Title I- Title I, Pjesa A e Aktit “Çdo Nxënës të Jetë i Suksesshëm”, ofron asistencë financiare për agjensitë lokale të edukimit (LEAs) dhe shkollat, për përmirësimin e arritjeve mësimore për nxënësit e pafavorizuar. Ky grant jepet që të garantojë se të gjithë nxënësit kanë një mundësi të barabartë, të drejtë dhe domethënëse, për arritjen e një edukimi cilësisht të lartë dhe të arrijnë minimalisht aftësi në standardet mësimore dhe vlerësimet shtetërore.

Udhëzime

PJESA I. PRITSHMËRITË E PËRGJITHËSHME

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS është e përkushtuar në kujdesin dhe nxitjen e angazhimit të familjes dhe synon të rrisë këtë përfshirje, duke implementuar programe, aktivitete dhe procedura, të cilat theksojnë bashkëpunimin efektiv të familjes-shkollës-komunitetit dhe ndajnë përgjegjësitë për arritje të larta mësimore dhe suksesin e nxënësit. Për plotësimin e këtij synimi, këto nisma do të planifikohen dhe implementohen për:

- Nxitjen e një mjedisi mikpritës dhe të përgjegjshëm për të gjitha familjet pavarësisht rracës, ngjyrës, origjinës kombëtare, besimit fetar, indentitetit ose shprehjes gjinore, orientimit seksual, paaftësisë, moshës, statusit social-ekonomik, bindjeve politike, ose grupimeve të tjera të mbrojtura;
- Promovimin e pjesëmarrjes në angazhimin e familjes dhe komunitetit në drejtorinë arsimore, rrjetin e mësimit dhe në vendimmarrjet në nivelin e shkollës;
- Rritjen e aksesit në informacion, që të asistojë kujdestarët të hulumtojnë në fushat e drejtorisë arsimore, në mënyrë që fëmijët e tyre të mund të përfitojnë materialet e kërkuara, që i ndihmojnë ata të arrijnë maksimumin e potencialit të tyre mësimor;
- Përgjigjen ndaj shqetësimeve dhe/ose vrejtimeve të kujdestarëve, që të garantojë se nevojat e edukimit të fëmijëve janë arritur;
- Ofrimin e mundësive për kujdestarët që të marrin informacionin, njohuritë dhe aftësitë e nevojshëm, që të ndërtojnë kapacitetet për udhëheqje dhe mbrojtje të edukimit të fëmijëve të tyre në shtëpi dhe në shkollë;
- Sigurojnë përgjegjshmëri të personelit në të gjitha nivelet e Drejtorisë, në punën me kujdestarët si partnerë; dhe
- Vendosjen e pritshmërive të larta për shërbimin ndaj qytetarit (kujdestar/familje).

Programet dhe nismat e Drejtorisë përfshijnë:

- Ofrimin e shumë portave hyrëse, që mund të përdorin kujdestarët dhe komuniteti për marrjen e informacionit dhe mbështetjes për zgjidhjen e shqetësimeve të tyre nëpërmjet:

- Qendrës së Komunikimit të Drejtorisë Arsimore në tel. 215-400-4000, e cila ofron informacion të plotë për shërbimet e Drejtorisë, nismat dhe programet, linket ndihmëse që lehtësojnë komunikimin midis qytetarëve dhe Zyrave përkatëse të Drejtorisë dhe punojnë drejtëpërsëdrejti me shkollat dhe rrjetet mësimore për adresimin e pyetjeve dhe shqetësimeve të prindërve, nëpërmjet trajtimit një- për- një, të çeshtjeve;
- Qendra Burimore e Familjes dhe Prindit, e cila i ofron kujdestarit mbështetje personale për zgjidhjen e shqetësimit dhe eksplorimin e rrugëve për mbështetje më të mirë të edukimit të fëmijës, ndihmon kujdestarët për njohjen e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, ofron njohje për politikat, procedurat, programet dhe shërbimet e Drejtorisë, ndan informacione për programet dhe burimet me bazë drejtorie dhe është mikpritëse për seminare dhe aktivitete; dhe
- Koordinatorët e Përfshirjes së Familjes dhe Komunitetit dhe Koordinatorët e Angazhimit të Familjes, të cilët midis shumë detyrave të tyre përfshijnë edhe asistimin e shkollave në shtrirjen e mundësive të angazhimit të familjes dhe ndërtimin e një bashkëpunimi shkollë-familje, mbështetjen e kujdestarëve në zgjidhjen e shqetësimeve të tyre, nëpërmjet menaxhimit të çeshtjeve një-për-një, duke vepruar si ndërlidhës midis zyrave qëndrore/personelit të shkollës dhe familjeve, mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit rreth shërbimeve dhe burimeve të ndryshme, organizimin dhe lehtësimin e seminareve me kujdestarët dhe panairët informative, ndihmën ndaj shkollave për formimin e Këshillit Konsultativ të Shkollës dhe duke ofruar shërbime të tjera për nevojat e ndryshme të të gjitha familjeve.
- Përmirësimin e Aksesit në Informacion
 - Realizimin e Informacionit për programet, shërbimet, proceset dhe procedurat e drejtorisë , që janë në uebsajtin e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias www.philasd.org;
 - Përdorimin “Facebook” dhe “Twitter” dhe nëpërmjet partnerëve të medias tradicionale për ndarjen e informacionit për familjet dhe komunitetin;
 - Implementimin e AskPhilaSD (<http://ask.philasd.org>) – një sistem menaxhimi i njohurive, i cili përdor teknologjinë për përgjigje në çast të pyetjeve më të shpeshta; Lançimin e Portalit Prindi dhe Familja, i cili i ofron kujdestarëve një rrugë të re që të jenë të përditësuar me të rejtat që ndodhin në Drejtori dhe në shkollën e fëmijës së tyre, nëpërmjet një llogarie online, e cila u mundëson atyre të përditësojnë informacionin e kontaktit, nëse ai ndryshon, zgjedhjen e mjeteve të komunikimit, të cilat funksionojnë më mirë për ata (tekst mesazhe, telefonatë ose e-maile), shënojnë tipet e ndryshme të përditësimit, si edhe marrin akses në frekuentimin dhe notat e fëmijës së tyre.
- Sigurojnë Hyrje të Dhënash dhe Vlerësime

- Ofrojnë përditësime për të rejat e fundit në Drejtorinë Arsimore duke ftuar të gjitha grupet e interesuara, përfshirë kujdestarët, nxënësit, stafin dhe pjesëtarët e komunitetit, për pjesëmarrje në Turin e Dëgjimit të Superintendentit, takimet me Asistentin e Superintendentit dhe takime të tjera të shkollës për tërheqjen e mendimeve, ideve të reja dhe opinioneve për politikën dhe përparësitë e Drejtorisë.
- Fuqizimin e përfshirjes së familjes dhe komunitetit në vendimmarrjet e shkollës nëpërmjet implementimit në gjithë Drejtorinë të Këshillave Konsultativë të Shkollës (SAC) – një trupë këshillimore, që garanton përfaqësimin e shkollës, kur diskutohen çështje të cilat ndikojnë të gjithë shkollën. Duke sjellë bashkë, përfaqësues të zgjedhur nga të gjitha grupet e interesuara: kujdestarët (të cilët përbëjnë shumicën në SAC), drejtuesit dhe personeli i shkollës, partnerët e komunitetit dhe nxënësit (në shkollat e mesme). SAC_u ofron një platformë për diskutime dhe bashkëpunime, që garantojnë suksesin e nxënësve
- Të ofrojë më shumë mundësi për kujdestarët të marrin pjesë në dialogë që informojnë dhe influencojnë politikën dhe vendim marrjet, që lidhen me çështje të gjithë drejtorisë, Drejtoria do të fillojë aktivitete për formimin e Këshillit Konsultativ të Familjes, me shtrirje në të gjithë Drejtorinë Arsimore.
- Duke punuar nga afër me kujdestarët e interesuar dhe komunitetin, për ngritjen e vetëdijes ndaj rëndësisë të përfshirjes së tyre në nivel shkollë dhe drejtorie dhe t'i nxitë ata në ndërtimin e marrëdhënieve me mësuesit, drejtorët dhe personelin e shkollës, në ndjekjen e “Netëve Përsëri në Shkollë” dhe takimeve Prind-Mësues, në komunikimin e vazhdueshëm me shkollat, vizitën në klasën e fëmijës së tyre, pjesëmarrjen në takimet dhe aktivitetet e shkollës, punën vullnetare, bashkimin në grupet e prindërve dhe kryerjen e një roli drejtues.
- Mbështetjen e Familjeve me Ndryshime Kulturore dhe Gjuhësore—duke garantuar që familjet shumëgjuhëshe kanë qasje në informacion, mbështet përfshirjen e familjeve nëpërmjet:
 - Qendrës së Përkthimit dhe Interpretimit të Drejtorisë Arsimore, e cila ofron një gamë shërbimesh dhe mjetesh për lehtësimin e komunikimit me familjet shumëgjuhëshe, përfshirë qasjen në shërbimin e interpretimit telefonik, në më shumë se 170 gjuhë dhe dialekte të ndryshme, përkthimin e dokumentave të Drejtorisë dhe shkollave, mbajtjen e një arkive online me dokumentat e përkthyer dhe menaxhimin e faqeve për kujdestarët dhe komunitetin, në tetë prej gjuhëve më të përdorura të Drejtorisë (Spanjisht, Kineze, Arabe, Vietnameze, Franceze, Khmere, Ruse dhe Shqip).
 - Shërbimet Mbështetëse për Familjet Shumëgjuhëshe, të cilat ndihmojnë familjet shumëgjuhëshe të ndërtojnë komunikim të vazhdueshëm me shkollën dhe të kenë qasje në informacionin e Drejtorisë dhe materialet e burimit, në gjuhën e tyre amtare; nëpërmjet shërbimeve të Asistentë Këshillëtarëve Dygjuhësh, ofron qasje në interpretimin e menjëhershëm në takimet, konferencat, aktivitetet e shkollës dhe drejtorisë, ndërton bashkëpunim me organizatat në shërbim të imigrantëve dhe refugjatëve dhe mbështet familjet nëpërmjet seminareve dhe trajnimeve për refugjatët dhe imigrantët, të quajtura “Vagonët e Mirëseardhjes”. “Vagonët e

Mirëseardhjes” shpërndahen në komunitet në kohë të përshtatëshme për kujdestarët dhe në gjuhën e tyre amtare. Ato adresojnë një variacion tematikash të rëndësishme për komunitetin e imigrantëve, përfshirë shkrim-leximin, procesin e aplikimit për në kolegji dhe burimet për ndihmë financiare, siguria në punësim, qasja në përfitimet mjekësore, menaxhimi i azmës, mbrojtja nga HIV, kalimi në jetën e SH.B.A, asimilimi kulturor dhe konfliktet prind/fëmijë, praktikat në rritjen e fëmijës dhe disiplina, njohja dhe kërkimi i trajtimit për depresion, njohja e dhunës në familje dhe parandalimi i abuzimit me fëmijët.

- Përmirësimi i Shërbimit ndaj Qytetarit
 - Për Drejtorinë, që t’ju përgjigjet më mirë kujdestarëve përmes një bashkëpunimi midis Zyrës së Shërbimeve Teknologjike dhe Zyrës së Përfshirjes së Familjes dhe Komunitetit, Drejtoria do të përmirësojë sistemin e pyetjeve nga telefoni dhe do të publikojë zhvillimet e mëtejshme në: ask.philasd.org, vendndodhjen e informacionit dhe të interesuarve.
 - Aktivisht kërkon dhe i përgjigjet opinioneve mbi efektivitetin e shkollave dhe departamenteve tona kryesore, nëpërmjet pyetësoreve, grupeve të punës dhe video konferencave. Drejtoria do të përdorë dhe do të kërkojë të rritë pjesëmarrjen në Zyrën e Kërkimit dhe Vlerësimit, të pyetësorëve vjetorë të nxënësve, prindërve dhe kujdestarëve; do të mbështesë veprimet e grupeve të pyetësorëve dhe atyre të veprimit; do të ftojë nxënësit, kujdestarët dhe të interesuarit nga komuniteti, për pjesëmarrje në grupet e punës, nga ku të tërhiqen mendime për përmirësimin e përvojave mësimore të nxënësve; do të zgjerojë praktikat më të mira për tërheqjen e mendimit të nxënësve; dhe planifikimin e takimeve në të gjitha rrjetet mësimore të Drejtorisë Arsimore.
 - Drejtoria Arsimore do të ofrojë trajnime për shërbimin ndaj qytetarëve me mësuesit, administratorët, sekretaret, personelin e zyrës qendrore dhe personelin mbështetës, të cilat janë konceptuar për përmirësimin e veprimeve reciproke midis familjeve dhe shkollave.
 - Implementojë një qasje për shërbimin ndaj qytetarëve, e cila lëviz drejt shkollave dhe zyrave miqësore ndaj familjeve, të cilat kur angazhohen me familjet, fokusohen në parimet e mëposhtëme:
 - Njohja. I pranon kujdestarët si partnerë në kujdesin dhe edukimin e fëmijëve.
 - Respekti. Vlerëson kujdestarët dhe dëgjon aktivisht atë që shprehin ata.
 - Përgjigja. Vepron menjëherë dhe i përgjigjet me sinqeritet pyetjeve dhe zgjidhjes së problemeve të tyre.
 - Kërkimore. Studion çështjet që lidhen me fëmijët dhe familjet në komunitet dhe mbështet kualifikimin profesional.
 - Zgjidhja. Punon bashkërisht me kujdestarët për zgjidhjen e çdo çështjeje dhe problemevi.

- Rivendos besimin. Nëse besimi dështon, komunikon shpesh, mban premtimet dhe demonstroi integritet.

PJESA II. KËRKESAT STATUTORE

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS pranon të përfshijë kërkesat e mëposhtëme statutore:

- Drejtoria Arsimore do të verë në funksionim programe, aktivitete dhe procedura për përfshirjen e kujdestarëve në të gjitha shkollat e saj, në përputhje me seksionin 1116 të Aktit “Çdo Nxënës të jetë i Suksesshëm” (ESSA), të programeve të Title I, Pjesa A. Këto programe, aktivitete dhe procedura do të planifikohen dhe vihen në veprim me një konsultim të dobishëm me kujdestarët e fëmijëve pjesëmarrës.
- Në përputhje me seksionin 1116, Drejtoria Arsimore do të punojë me shkollat e saj, që të garantojë se kërkesat e politikave të përfshirjes së familjes në nivelin e shkollës, janë në përputhje me seksionin 1116(b) të ESSA, dhe secila përfshin si një komponent marrëveshjen shkollë-prind, në përshtatje me seksionin 1116(d) të ESSA.
- Në zbatimin deri ku janë mundësitë praktike të kërkesave të përfshirjes të prindit dhe familjes, sipas Title I, Pjesa A, Drejtoria Arsimore dhe shkollat e saj do të ofrojnë mundësitë e plota për pjesëmarrjen e kujdestarëve me mungesa në të folurën e gjuhës Angleze, të kujdestarëve me paaftësi dhe kujdestarëve të fëmijëve migratorë, përfshirë informacionin dhe raportet shkollore, sipas seksionit 1111 të ESSA, në një gjuhë të kuptueshme dhe në format uniform dhe sipas kërkesave dhe mundësive praktike, në një gjuhë që flitet nga kujdestari i fëmijës.
- Drejtoria Arsimore do të përfshijë kujdestarët e fëmijëve që u shërbehet sipas Title I, Pjesa A në vendimmarrjet e shkollave për përdorimin e 1 përqind të fondeve të Title I, Pjesa A, të rezervuara për shpenzime të pjesëmarrjes së prindit dhe familjes dhe do të garantojë që jo më pak se 95 përqind e këtij 1 përqindëshi, do të shkojë direkt në shkolla për aktivitete që lidhen me prindërit, sipas marrëveshjes midis prindërve dhe administratës shkollore të miratuar nga Këshilli Konsultativ i Shkollës (SAC), ose organizata të ngjashme të grupeve prind/familje dhe administratës së shkollës.
- Drejtoria Arsimore do të garantojë që të gjitha shkollat e saj, do të organizojnë së paku një herë në vit takime të prindërve, ku do të përfshihen të gjithë pjesëmarrësit e interesuar në diskutimin e programeve dhe aktiviteteve egzistuese për përfshirjen e familjes, se si ato të implementohen në shkollë nëpërmjet fondeve të vëna nga Title I për përfshirjen e familjeve dhe arritjen e një marrëveshjeje me kujdestarët për shpenzimet dhe bashkëpunimin e mëtejshëm në zbatimin e këtyre programeve dhe aktiviteteve.
- Drejtoria Arsimore do të njoftojë shkollat, që mos zbatimi i këtyre kërkesave të nënvizuara në këtë seksion dhe në pjesën tjetër të kësaj politike, mund të rrezikojë fondet e tyre të parashikuara në Title I.

- Zyra Qëndrore në Drejtorinë Arsimore do të organizojë një seri takimesh me kujdestarët përpara fillimit të procesit vjetor të shpërndarjes së buxhetit, që të tërheqë mendimet për shpërndarjen e fondeve të akorduara nga federali, sipas përmbajtjes të Aplikimeve Federale të Drejtorive Arsimore me Departamentin e Edukimit të Pensilvanisë.

PJESA III. PËRSHKRIM SE SI DREJTORIA DO TË ZBATOJË KOMPONENTET E POLITIKAVE TË SAJA PËR PËRFSHIRJEN E PRINDIT DHE FAMILJES

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS do të ndërmarrë veprimet e mëposhtëme për përfshirjen e kujdestarëve dhe familjeve në planin e zhvillimit të përbashkët, sipas seksionit 1112 të ESSA:

- Çdo vit, Drejtoria do të drejtojë një vlerësim të përmbajtjes dhe efektivitetit të politikës së Drejtorisë Arsimore për përfshirjen e prindit dhe familjes, aktiviteteve dhe programeve.
- Në pranverë, kujdestarët dhe të interesuar nga komuniteti janë të ftuar të marrin pjesë në grupe të ndryshme pune, që mundësojnë marrjen e mendimeve të ndryshme për efektivitetin e politikës së përfshirjes së familjes dhe prindit. Kujdestarët do të njoftohen për grupet e punës nëpërmjet shumë rrugëve si, email, fletushka, telefonatave automatike, medias sociale dhe njoftimeve të shpallura nga uebsajtet e Drejtorisë Arsimore. Gjatë punës në këto grupe, pjesëmarrësit do të njihen me të rejtat e fundit dhe do të japin mendime në politikën e re/të rishikuar. Shtesat/Heqjet/Rishikimet që janë diskutuar dhe miratuar gjatë këtyre takimeve. Formatimet dhe rishikimet që janë kryer pas takimeve dhe janë dërguar përsëri te pjesëmarrësit për komente të ndryshme. Familjet dhe të interesuarit nga komuniteti, që e kanë të pamundur të ndjekin personalisht këto grupe pune, e kanë këtë mundësi që t'a ndjekin atë online, duke u mundësuar që të rishikojnë dokumentin dhe të japin mendimet e tyre në mënyrë elektronike.
- Kujdestarët janë të mirëpritur të japin në çdo kohë mendimet e tyre nëpërmjet uebsajtit të Drejtorisë Arsimore, ose duke i dërguar komentet e tyre në shkollën e fëmijës. Të gjitha mendimet dhe komentet e marra do të merren në konsideratë gjatë kohës së rishikimit të përvitshëm të politikës.
- Në kohën kur politika e përfshirjes së familjes dhe prindit është finalizuar, dokumenti përfundimtar do të postohet në uebsajtin e Drejtorisë Arsimore, kopje të printuara të saj do të jenë të vlefshme në takimet vjetore të Title I, që organizohen në çdo shkollë dhe gjithashtu do të shpërndahen në shtëpi nëpërmjet nxënësve.
- Drejtoria Arsimore do të dërgojë një direktivë (të firmosur nga Superintendenti) te Asistent Superintendentët dhe Drejtorët, pavarësisht shpërndarjes të politikës së Drejtorisë te kujdestarët dhe personeli.

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS do të ndërmarrë veprimet e mëposhtëme për përfshirjen e kujdestarëve në procesin e rishikimit të shkollës, sipas seksionit 1114 të ESSA:

- Të gjitha shkollat e Drejtorisë do të kenë një Këshill Konsultativ të Shkollës(SAC),aktiv dhe të angazhuar, të kompozuar në shumicë nga pjestarë të familjeve, drejtorin e

shkollës, mësues, ose pjesë tjetër e personelit, nxënës dhe pjestarë të komunitetit, të cilët punojnë me devotshmëri për përmirësimin e arritjeve të nxënësve, mësimdhënie efektive në klasë, kujdestarë dhe komunitet i angazhuar në procesin edukues dhe lehtëson komunikimin dhe mbështetjen.

- Përfaqësuesit e duhur të Drejtorisë do të jenë të gatshëm të bashkëpunojnë aktivisht me drejtuesit e prindërve, Zyrën e Përfshirjes së Familjes dhe Komunitetit, që të ofrojnë trajnime në nivel shkolle, Rrjeti mësimor dhe Drejtorie, për aspekte të veçanta të Title I, përfshirë kuptimin e të dhënave të shkollës, Planin Gjithëpërfshirës të buxhetit të shkollës dhe procesin e hartimit të buxhetit.
- Shkollat do të zhvillojnë mjetet për marrjen e mendimeve të prindërve dhe firmave të personelit jashtë drejtorisë, në Planin Gjithëpërfshirës, buxhetin e Title I dhe Planin e Përmirësimit të Shkollës (SIP).
- Ofron më përpara njoftime për prindërit për takimet, ose anulimin e tyre, nëpërmjet letrave, telefonimeve automatike, standave të njoftimeve, grupeve të organizuara prind/familje dhe dërgesave në shtëpi.
- Kualifikimi profesional do të ofrohet për Këshillat Konsultativë të Shkollës (personelin e shkollës, nxënësit, familjet dhe partnerët e komunitetit) ose grupet e tjera të organizuara prind/familje, që të ndihmojë në kuptimin e përgjegjësive të secilit faktor në këtë proces.
- Qendra e Përkthimit dhe Interpretimit dhe Mbështetjes të Familjeve Shumëgjuhëshe, e Drejtorisë Arsimore, do të ofrojë shërbime të plota përkthimi dhe interpretimi për familjet dhe kujdestarët me aftësi të kufizuara në Anglisht.

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS do të ofrojë koordinimin, asistencën teknike, dhe mbështetje të tjera, që të asistojë shkollat e Title I, Pjesa A, në planifikimin dhe zbatimin efektiv të aktiviteteve për përfshirjen e familjeve, për përmirësimin e arritjeve mësimore të nxënësve dhe performancës së shkollës:

- Në bashkëpunim me grupet e prindit dhe familjes, ofron mbledhje pune në shkollat për përfshirjen e familjes.
- Ofron kualifikim profesional, që ndihmohet nga prindërit/kujdestarët, për drejtorët e rinj dhe egzistues dhe administratorët e tjerë, se si të përfshihen dhe angazhohen sa më efektivisht prindërit/kujdestarët.
- Trajnon personelin e ri dhe egzistues me detyrat që shoqërojnë përfshirjen e familjeve (p.sh., Këshillat Konsultativë të Shkollave, Ndërlidhësit e Përfshirjes së Familjes, Ndërlidhësit e Marrëdhënive me komunitetin, Ndërlidhësit e Mbështetjes të Përmirësimit të Shkollës dhe Asistentëve Këshillues Dygjuhësh) për të asistuar shkollat në implementimin e praktikave dhe programeve më të mira.
- Zyra e Title I dhe Zyra e Angazhimit të Familjes dhe Komunitetit, do të ofrojnë seminare dhe asistencë teknike për shkollat, prindërit dhe organizatat e komunitetit.

- Ofron trajnime për prindërit ku përfshihen, por nuk kufizohen në përgatitjet për testet e PSSA dhe Keystone në, lexim, matematikë, shkencë.
- Ofron trajnime për prindërit ku përfshihen siguria në shkollë, diversiteti kulturor, zgjidhja e konflikteve, si të përfshihesh në shkollë, përmirësimi i angazhimit të familjes dhe sipas kërkesave, edhe çeshtje të tjera.
- Trajnon kujdestarët që të shërbejnë si ndërlidhës midis drejtorëve dhe SAC_ut për nismat në Drejtorinë Arsimore dhe në nivelin e rrjetit mësimor.
- Në përshtatje me Planin 3.0, të Veprimit të Drejtorisë, nxit aksesin e prindit/kujdestarit të mësuesit dhe drejtorët.

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS do të koordinojë dhe integrojë strategjitë e përshtirjes së familjes të Title I, Pjesa A me strategjitë e përfshirjes së familjeve, sipas programeve të tjera si: “Head Start”, “Bright Futures” dhe “Education Leading to Employment and Career Training” (ELECT), nëpërmjet:

- Mbatjes së takimeve tre mujore midis personelit të programit “Pre-K” dhe “ELECT”, që janë përgjegjës për angazhimin e familjes dhe Zyrës së Përfshirjes së Familjes dhe Komunitetit. Protokollet e këtyre takimeve mund të vihen në dispozicion sipas kërkesave.
- Duke ftuar prindërit/kujdestarët e nxënësve të Parashkollorëve dhe prindërit e rinj për pjesëmarrje në takimet, ngjarjet dhe aktivitetet e Drejtorisë Arsimore.

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS do të ndërmarrë një pyetësor vjetor për gjithë drejtorinë me Prindërit/Kujdestarët për mbledhjen e të dhënave në nivel shkollor për rezultatet e përfshirjes së familjeve dhe do të tërheqë mendimet e prindërve gjatë hartimit të pyetësorit dhe rishikimit të procesit.

Rezultatet e pyetësorit do të përdoren për identifikimin e barrierave që pengojnë një pjesëmarrje më të gjerë të familjarëve në aktivitetet për përfshirjen e familjes (me një vemëndje të veçantë ndaj familjeve që kanë mungesa ekonomike, janë të paaftë, kanë mungesa në Anglisht, kanë shkollim të pamjaftueshëm, ose janë nga grupe racore dhe etnike në minorancë). Drejtoria Arsimore do të përdorë rezultatet për përcaktimin e strategjive më efektive të përfshirjes së familjes dhe për të rishikuar, nëse është e nevojshme (edhe me përfshirjen e prindërve/kujdestarëve) politikat e saja për angazhimin e familjes.

Qëllimi kryesor i Politikës së Përfshirjes së Prindit dhe Familjes, është të fuqizojë angazhimin e familjes në Drejtorinë Arsimore të Filadelfias. Brënda këtij qëllimi kryesor evidentohen tre drejtime:

- a) përfshirjen e mendimeve të prindit në politikat dhe procedurat e Drejtorisë;
- b) bërjen e shkollave dhe burimeve të saj mësimore dhe edukuese, më të ofrueshme për prindin/kujdestarin, dhe;
- c) të ofrojë mundësi për prindin/kujdestarin të fitojë sa më tepër informacion për arritjet mësimore të fëmijës dhe se si të shfrytëzojë burimet për mbështetjen e edukimit të fëmijës.

Në vartësi të burimeve të mundëshme, Zyra e Kërkimit dhe Vlerësimit (ORE), ose një vlerësues i jashtëm, që funksionon nën drejtimin e ORE, do të aplikojë metodat e mëposhtëme për vlerësimin e gjëndjes së objektivit të synuar dhe arritjeve në drejtimet e caktuara: elektronike dhe me letër (përfshirë Pyetësorin e Drejtorisë për administratorët, mësuesit, kujdestarët dhe nxënësit), grupet e punës së prindërve, analizat e raporteve, si dhe vërtetimet e takimeve dhe seminareve trajnuese.

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS do të ndërmarrë veprimet e mëposhtëme për ndërtimin e kapaciteteve të shkollave dhe prindërve, për një fuqizim të angazhimit të familjes, në mënyrë që të sigurojë një përfshirje efektive të prindërve/kujdestarëve dhe për mbështetjen e bashkëpunimit midis shkollës, kujdestarëve dhe komunitetit, për përmirësimin e arritjeve mësimore të nxënësve:

A. Drejtoria Arsimore me asistencën e zyrave të saj (Përfshirja e Familjes dhe Komunitetit; Shërbimet Fiskale dhe të Pajtueshmërisë me Grantet; Menaxhimi dhe Buxheti; Shërbimet Mësimore të Specializuara; Kurrikula, Mësimdhënia dhe Vlerësimi), do të ndërmarrin veprimet e mëposhtëme, që të ofrojnë asistencë për kujdestarët e fëmijëve që u shërbehet nga Drejtoria Arsimore, ose shkolla në kuptimin e tematikave, si më poshtë:

- përmbajtja e standardeve mësimore të shtetit;
- standardet shtetërore të arritjeve mësimore të nxënësit;
- standardet shtetërore dhe lokale të vlerësimeve, përfshirë vlerësimet alternative;
- kërkesat e Title I, Pjesa A;
- si të monitorohet progresi i fëmijëve të tyre; dhe
- si të punohet me edukatorët.

- Zyra e Shërbimeve Fiskale dhe e Pajtueshmërisë me Grantet do të jetë e gatëshme të bashkëpunojë me zyrat e tjera dhe grupet e prindërve që të ofrojë prezantime dhe seminare rreth kërkesave të Title I dhe të drejtat e prindërve për njohjen e tyre, sipas Aktit “ Çdo fëmijë të jetë i Suksesshëm”.
- Rekomandon që gjatë ditëve të kualifikimit profesional në shkollë, kur është e mundëshme, drejtorët të përfshijnë edhe prindër/kujdestarë.
- Rekomandon që gjatë ditëve të kualifikimit profesional në shkollë, drejtorët të shtojnë një komponent për kujdestarët.
- Sponsorizon dhe nxit shkollat për mbështetjen e pjesëmarrjes së prindërve në konferenca dhe seminare, të tilla si Konferenca Vjetore Shtetërore e Këshillit Konsultativ të Prindit, Konferenca Vjetore për Angazhimin e Familjes (Koalicioni për Përfshirjen e Prindit i PA), dhe të tjera.
 - Kërkon që prindërit/kujdestarët që dëshirojnë të ndjekin konferencat të verifikojnë që trajnimet e kërkuara janë realizuar si në nivelin e shkollës edhe në atë të Drejtorisë. Verifikimi do të jetë: 1) fleta e pjesëmarrjes e firmosur; 2) rendi i ditës; dhe 3) kopje të dokumentave të shpërndara.

- Garantoni që secili prind/kujdestar i zgjedhur për pjesëmarrje në nivel shteti, ose kombëtar, ka ndjekur rregullisht takimet e Drejtorisë për përfshirjen e familjes dhe ka plotësuar një raport (verbal ose me shkrim).
 - Ofron informacion për kujdestarët në një gjuhë të qartë dhe të thjeshtë.
 - Sipas mundësive praktike, ofron seminare në gjuhën amtare të familjeve, gjuhë e cila është e ndryshme nga Anglishtja.
 - Shpërndan për prindërit materiale nga Zyra e Kurrikulës dhe Mësimdhënies dhe zyra të tjera, të cilat do të jenë referenca të dobishme në shtëpi, përfshirë, aty ku është e mundëshme edhe materiale të përkthyer.
- B. Drejtoria Arsimore me asistencën e shkollave të saj do të ofrojë materiale dhe trajnime për të ndihmuar punën e prindërve/kujdestarëve me fëmijët e tyre, për përmirësimin e arritjeve mësimore, të tilla si shkrim-lexim dhe seminare teknologjike, për nxitjen e angazhimit të familjes:
- Duke implementuar seminarat e prindit në gjithë qytetin për të ofruar një gamë të gjerë të ofertave edukuese nga personeli i Drejtorisë Arsimore dhe ofruar të tjerë, përfshirë se si të mbështetet një fëmijë në shkollë dhe literaturë kompjuterike.
 - Duke ofruar trajnime të literaturës kompjuterike dhe trajnime të tjera për prindërit, përfshirë përdorimin e portalit Prindi dhe Familja, si një mjet për monitorimin e arritjeve mësimore të fëmijëve të tyre.
 - Duke mbështetur shkollat në planifikimin dhe implementimin e aktiviteteve me bazë shkolle, të tilla si netët familjare për letërsinë, për matematikën dhe seminare të tjera, që ndihmojnë prindërit/kujdestarët se si mbështetin arritjet mësimore të fëmijëve, me asistencën e Zyrave përkatëse të Drejtorisë.
 - Duke organizuar me personelin e Drejtorisë trajnime dhe prezantime për kujdestarët dhe organizatat e komunitetit.
 - Duke ofruar seminarat e mësipërme edhe në vende të tjera të komunitetit, të tilla si bibliotekat, organizatat e komunitetit, ku familjet mund të ndjehen më të lirëshme.
 - Duke ofruar kur është e mundëshme, që materialet dhe seminarat e mësipërme të jenë edhe në gjuhë të tjera përveç Anglishtes.
- C. Zyra e Përfshirjes së Familjes dhe Komunitetit me asistencën e prindërve/kujdestarëve do të mundësojë drejtimin e sesioneve të kualifikimit profesional në shkollat për edukimin e mësuesve, drejtorëve, stafit, që është në shërbim të nxënësve dhe personelit tjetër, se si mund të qasen, komunikojnë dhe punojnë me prindërit, si partnerë të barabartë, në vlerat dhe dobinë e kontributeve të prindërve dhe se si të implementojnë dhe koordinojnë programet dhe të ndërtojnë lidhje midis prindërve dhe shkollave:
- Me ndihmën e koordinatorëve të prindit për të ofruar mundësi të kualifikimit profesional për drejtorët dhe administratorët e tjerë, se si të realizohet bashkëpunimi i premtuar me prindërit/kujdestarët.
 - Planifikon takime të rregullta midis Zyrës së Përfshirjes së Familjes dhe Komunitetit, përfaqësuesve të SAC, ose të tjerëve për pjesëmarrje në rishikim të

Politikës të Angazhimit të Prindit dhe Familjes për shkollat e “Title I” dhe marrëveshjes Prind- Shkollë (nëse kërkohet).

D. Drejtoria Arsimore sipas rastit, do të koordinojë dhe integrojë, programet e përfshirjes së familjesh dhe aktivitetet me “Head Start, Bright Futures, ELECT” dhe programe të tjerë, sa të jetë e mundur, do të drejtojë aktivitetet e tjera, të tilla si qendrat burimore të prindit, të cilat nxitin dhe mbështetin prindërit/kujdestarët në pjesëmarrje më të plotë për edukimin e fëmijëve të tyre:

- Duke rritur bashkëpunimin midis personelit përgjegjës të programeve Pre-K dhe ELECT, për përfshirjen e familjeve dhe Zyrës së Përfshirjes të Familjes dhe Komunitetit.
- Duke rekrutuar prindërit/kujdestarët e nxënësve të Pre-K, për pjesëmarrje në takimet, eventet dhe aktivitetet e organizuara nga Drejtoria Arsimore.

E. Drejtoria Arsimore do të ndërmarrë veprimet e mëposhtëme për të garantuar që informacioni, i cili lidhet me programet shkollore dhe të prindërve, takimet dhe aktivitetet e tjera, i dërgohet prindërve të nxënësve pjesëmarrës në një gjuhë dhe format të thjeshtë dhe të kuptueshëm, përfshirë sipas kërkesës edhe formate alternativë dhe aty ku është e mundëshme, në gjuhën amtare të cilën prindërit e kuptojnë më mirë:

- Deri ku praktikisht mundësohet, ofron gjuhë të thjeshtë dhe të qartë.
- Poston komunikimin me prindin në Uebfaqin dhe Facebook_un e Drejtorisë.
- Garanton që komunikimi me Drejtorinë përfshin edhe një numër telefoni, ku prindi mund të flasë për sqarime.
- Ndan informacionin e rëndësishëm me Qendrën Telefonike të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias dhe Qendrën Kryesore Informativë me Nr.215-400-4000, me Koordinatorët e Përfshirjes së Familjes dhe Komunitetit, Koordinatorët e Përfshirjes së Familjes dhe Asistentët Këshillues Dygjuhësh, kështu që ata mund t’ a ndajnë këtë informacion me familjet dhe ofrojnë sqarime për komunikatat e rëndësishme të Drejtorisë.
- Mirëpret takimet dhe seminarët e prindërve dhe komunitetit për trajtimin e tematikave më të rëndësishme.
- Kërkon nga partnerët e komunitetit, përfshirë bibliotekat, qendrat argëtuese, organizatat e komunitetit dhe ato me bazë fetare, që të asistojnë në shpërndarjen e informacionit.
- Ofron kur kërkohet, shërbime gjuhësore për familjet që flasin gjuhë tjetër nga Anglishtja, nëpërmjet përkthimit në vend, ose shërbimit me përkthim nga telefoni

PJESA IV. KOMPONENTE TË TJERA TË POLITIKËS SË DREJTORISË ARSIMORE PËR PËRFSHIRJEN E PRINDIT DHE FAMILJES

- Duke përfshirë prindërit në zhvillimin e trajnimit për mësuesit, drejtorët dhe personelit tjetër edukues, për përmirësimin e efektivitetit të këtij trajnimi;

- Duke paguar shpenzimet e nevojshme dhe të arsyeshme, kur e lejon buxheti, që lidhen me aktivitetet e angazhimit të familjes, përfshirë transportin dhe kujdesin për fëmijët, ç'ka u mundëson prindërve të marrin pjesë në takimet dhe trajnimet në shkollë;
- Duke trajnuar prindërit të zgjerojnë pjesëmarrjen e prindërve/kujdestarëve të tjerë;
- Duke planifikuar në orare të ndryshme takimet e shkollës, ose konferencat në shtëpi, midis mësuesve dhe edukatorëve të tjerë, që punojnë direkt me fëmijët pjesëmarrës, me prindërit/kujdestarët, që nuk kanë mundësi të vijnë në shkollë; në mënyrë që të maksimalizohet përfshirja e familjes në edukimin e fëmijëve;
- Duke kërkuar, adoptuar dhe implementuar modelet e duhura për përmirësimin e përfshirjes së familjes;
- Duke krijuar një këshilli konsultativ të prindit në nivel drejtorie, i gjithëpërfaqësuar dhe i gjithëpërfshirë, i gatshëm të japë mendimet për të gjitha çështjet që lidhen me angazhimin e familjes në programet e Title I, Pjesa A;
- Duke zhvilluar rolin e duhur për organizatat e komunitetit dhe biznesit, përfshirë edhe ato me bazë fetare, në aktivitetet e përfshirjes së familjes; dhe
- Sipas kërkesave të prindërve/kujdestarëve, duke ofruar mbështetje të tjera të arsyeshme për aktivitetet e angazhimit të familjes, sipas seksionit 1116.

PJESA V. ADOPTIMI

Kjo Politikë e Drejtorisë Arsimore për Përfshirjen e Prindit dhe Familjes, është realizuar bashkërisht dhe është miratuar me prindërit/kujdestarët e fëmijëve pjesëmarrës në programet e Title I, Pjesa A, siç edhe evidentohet nga rendi i ditës, fletët e firmosura të pjesëmarrjes dhe mendimet e shprehura online dhe gjatë takimeve.

Kjo politikë është adoptuar nga DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS në datën 17 Nëntor 2016 dhe do të jetë efektive deri në një rishikim tjetër. Drejtoria Arsimore do të shpërndajë informacion në lidhje me këtë politikë te të gjithë prindërit/kujdestarët, deri në datën 30 Nëntor 2016.

Kjo politikë e zëvendëson Politikën 918.1.

Referencat Ligjore:

ESSA: 20 U.S.C. §§ 6316(b)(7), (8)
C.F.R. 34 C.F.R. § 200.36
State School Code: 24 P.S. § 1-101 *et seq.*, përfshirë 24 P.S. §§ 6-693, 6-696